

---

*Nga mormonandgay.lds.org.*

## **Përse e Përdorim Termin “Tërheqje ndaj së Njëjtës Gjini”? Përse Nuk Them Thjesht “Gej”?**

Tërheqja ndaj së njëjtës gjini (TNJGJ) i drejtohet tërheqjes emocionale, fizike, romantike ose seksuale ndaj një personi të së njëjtës gjini. Nëse përjetoni tërheqje ndaj së njëjtës gjini, ju mund të zgjidhni ose jo që të përdorni një etiketim për orientimin gjinor për ta përshkruar veten. Në të dyja rastet, tërheqja ndaj së njëjtës gjini është një term teknik që e përshkruan përvojën pa imponuar një etiketim. Kjo faqe interneti e përdor këtë term për të përfshirë njerëz që nuk ndihen rehat me përdorimin e një etiketimi, jo për të mohuar ekzistencën e identitetit të një geji, lesbikeje ose biseksuali.

## **Përse Faqja e Internetit Nuk i Diskuton Çështjet e Disforisë Gjinore ose ato Transgjinore?**

Shumë nga parimet e përgjithshme që tregohen në këtë faqe interneti (për shembull, rëndësia e përfshirjes dhe mirësisë), gjejnë zbatim për shenjtorët e ditëve të mëvonshme, të cilët përjetojnë disfori gjinore ose identifikohen si transgjinorë. Megjithatë, tërheqja ndaj së njëjtës gjini dhe disforia gjinore janë shumë të ndryshme. Për shembull, ata, të cilët përjetojnë disfori gjinore, gjithashtu mund të përjetojnë ose jo tërheqje ndaj së njëjtës gjini dhe pjesa më e madhe e atyre që përjetojnë tërheqje ndaj së njëjtës gjini, nuk dëshirojnë që ta ndryshojnë gjininë e tyre. Nga një këndvështrim psikologjik dhe kishtar, të dyja janë të ndryshme.

## **A po e Pyetni Vetën nëse Jeni Gej?**

Në qoftë se po e pyetni vetën nëse jeni gej, ka gjasë që po përjetoni tërheqje ndaj së njëjtës gjini, dhe po e pyetni vetën se si t'i interpretoni këto ndjenja. Dëshirat seksuale janë të ndërlikuara dhe formohen nga shumë faktorë. Ndërkohë që tërheqja romantike, emocionale ose seksuale mund të sinjalizojë një orientim seksual, ju nuk duhet ta merrni si të vërtetë, në mënyrë të vetvetishme, që e sinjalizon atë. Dëshira seksuale mund të jetë e paqëndrueshme dhe e ndryshueshme. Nëse po e vini në dyshim, ju nuk duhet të ndiheni të shtyrë ose të ngutur për të arritur në përfundime rreth seksualitetit tuaj.

Fjalët nënkuptojnë gjëra të ndryshme për njerëz të ndryshëm dhe përkufizimi i një fjale mund të ndryshojë gjatë gjithë jetës sonë. Çfarë do të thotë për ju fjala *gej*? A është një ndjenjë? një identitet? një mënyrë jetese? Përdorimi i fjalës *gej* ka ndryshuar ndërkohë që ndryshojnë shoqëria dhe kultura. Identifikimi si gej mund të nënkuptojë që ju përjetoni tërheqje ndaj së njëjtës gjini, por zgjidhni që të mos veproni sipas këtyre ndjenjave. Ose ndoshta ky etiketim përshkruan mënyrën se si ju e shprehni vetveten emocionalisht, fizikisht, seksualisht ose politikisht. Nëse po vritni mendjen se çfarë nënkupton dikush kur thotë: “Unë jam gej”, thjesht pyetini ata.

## **A Duhet ta Bëj Publike?**

Për disa njerëz, mbajtja e fshehtë e ndjenjave të tërheqjes ndaj së njëjtës gjini, mund të çojë në turp ose në një dialog të brendshëm negativ. Shprehja e atyre ndjenjave me një njeri të besuar mund të jetë çliuese dhe shëruese. Disa njerëz, megjithatë, dëshirojnë që të kishin pritur më gjatë ose të paktën ta kishin kufizuar numrin e njerëzve të cilëve ua zbuluan ndjenjat e tyre, kështu që ky vendim nuk duhet të bazohet te nënshtrimi ndaj presionit për ta “bërë publike” ose për t’u identifikuar hapur si gej. Nëse vendosni t’i zbuloni ndjenjat e tërheqjes ndaj së njëjtës gjini, merrni parasysh me lutje se kujt do të donit t’i tregonit për të dhe se si do ta tregonit këtë aspekt të përvojës suaj në vdekshmëri.

Nëse vendosni t’i tregoni përvojat tuaja të të ndierit tërheqje ndaj së njëjtës gjini ose haptazi të identifikoheni si gej, ju duhet të përkraheni dhe të trajtoheni me mirësi e respekt, si në shtëpi ashtu edhe në Kishë. Ne të gjithë kemi nevojë të jemi të duruar me njëri-tjetrin ndërsa mësojmë t’i kuptojmë më mirë këto gjëra.

Si anëtarë të Kishës, ne të gjithë kemi përgjegjësi për të krijuar një mjedis përkrahës dhe të dashur për të gjithë vëllezërit e motrat tona. Një rrjet i tillë përkrahës e bën më të lehtë për ta jetuar ungjillin dhe për ta kërkuar Shpirtin ndërsa udhëtojmë përmes çfarëdo aspekti të vdekshmërisë.

## **Si Mund të Flas me Prindërit ose Peshkopin Tim rreth Tërheqjes ndaj së Njëjtës Gjini?**

Nëse ndiheni rehat për të folur me një prind, një pjesëtar tjetër të familjes ose një udhëheqës të Kishës, merrni parasysh t’ua shprehni ndjenjat tuaja atyre. Ndhimojini ata të kuptojnë se çfarë po kaloni në mënyrë që ata të mund të tregojnë dashuri dhe përkrahje. Nëse nuk e kuptojnë se me çfarë ngjason kjo përvojë, kërkoni atyre të lexojnë nga artikujt në këtë faqe interneti. Ky mund të mos jetë një bashkëbisedim i lehtë për t’u filluar, por është e rëndësishme që ta filloni një dialog. Jini të duruar me njerëzit rreth jush dhe mbani mend se ju të gjithë po mësoni së bashku. Nëse ata, të cilët i doni, kanë vështirësi për t’ju kuptuar ose për të qenë përkrahës, ata mund të kenë nevojë për ndihmën tuaj. Trajtojini prindërit dhe udhëheqësit tuaj me të njëjtën mirësi dhe respekt që ju shpresoni se ata do të tregojnë për ju. Kjo faqe interneti është krijuar për ta ndihmuar çdo njeri që ta kuptojë më mirë tërheqjen ndaj së njëjtës gjini nga një këndvështrim ungjillor.

## **Nëse Jam Mjaft Besnik, A do të Largohen Tërheqjet e Mia?**

Intensiteti i tërheqjes ndaj së njëjtës gjini nuk është një njësi matëse e besnikërisë suaj. Shumë njerëz luten me vite dhe bëjnë gjithçka munden që të jenë të bindur, prapëseprapë zbulojnë se ata ende tërhiqen ndaj së njëjtës gjini. Tërheqja ndaj së njëjtës gjini përjetohet në një shkallë të gjerë intensiteti dhe nuk është e njëjtë për këdo. Disa tërhiqen ndaj të dyja gjinive dhe të tjerë tërhiqen vetëm ndaj së njëjtës gjini. Për disa, ndjenjat e tërheqjes ndaj së njëjtës gjini, ose të paktën intensiteti i atyre ndjenjave, mund të zvogëlohen me kalimin e kohës. Gjithsesi, një ndryshim në tërheqje nuk duhet të pritët ose të kërkohet si një përfundim nga prindërit apo udhëheqësit.

Intensiteti i tërheqjeve tuaja mund të mos jetë nën kontrollin tuaj; megjithatë, ju mund të zgjidhni se si të përgjigjeni. Të pyeturit e Zotit se çfarë mund të mësoni nga kjo përvojë dhe në ç’mënyrë kjo mund të bëhet një forcë për ju, mund ta përqendrojë besimin tuaj te një rezultat që mund ta kontrollojë. Kthimi i jetës suaj te Perëndia është një veprim i rëndësishëm besimi që sjell bekime të mëdha tani dhe madje bekime më të mëdha në botën që vjen.

## **A do ta Ndryshojë Ndonjëherë Kisha Doktrinën e Saj dhe A do t’i Miratojë Martesat Mes së Njëjtës Gjini?**

Qendrore në planin e Perëndisë, doktrina e martesës midis një burri dhe një gruaje, është një mësim thelbësor i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe nuk do të ndryshojë:

“Si një parim doktrinor, i bazuar te shkrimet e shenjta, Kisha pohon se martesat midis një burri dhe një gruaje është thelbësore në planin e Krijuesit për fatin e përvetshëm të fëmijëve të Tij.

Marrëdhëniet seksuale janë të përshtatshme vetëm midis një burri dhe një gruaje që janë zyrtarisht dhe ligjërisht të martuar si bashkëshort e bashkëshorte. Çdo marrëdhënie tjetër seksuale, përfshirë ato midis personave të së njëjtës gjini, është mëkatore dhe e dëmton institucionin e familjes të krijuar në mënyrë hyjnore. Kisha në përputhje me këtë e pohon përcaktimin e martesës si bashkimin zyrtar dhe ligjor midis një burri dhe një gruaje” (*Handbook 2: Administering the Church [Manuali 2: Administrimi i Kishës]*, 21.4.10).